



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretarati@kqz.org



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 87 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe Planin Operacional të KQZ-së për vitin 2009 në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 10.08.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave për Fletëvotimin për Zgjedhjet Lokale, Zgjedhjet për Kryetar të Komunave dhe Raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit të Buxhetit dhe Prokurimit të KQZ-së i datës 07.08.2009 për përmbajtjen e specifikave të Fletëvotimit (FLV) për Zgjedhjet Lokale dhe Zgjedhjet për Kryetar të Komunave të datës 15 nëntor 2009, dhe Raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, dhe fillimin e procedurave të prokurimit për këtë qëllim.
- II. Kopjet e veçorive/specifikave të FLV-ve për si në pikën I, i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- III. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes i SKQZ-së që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datë 10 gusht 2009.

Prishtinë, 10 gusht 2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve